



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. dokumentit: 21.0.1-2011-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31
DHJETOR 2011

Prishtinë, Qershor 2012

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave	4
Përmbledhje e përgjithshme	5
1 Hyrje.....	6
2 Opinioni i auditimit	8
3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar	8
4 Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar	9
5 Pasqyrat vjetore financiare – Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit.....	11
6 Menaxhimi financiar.....	12
6.1 Shpenzimet.....	12
6.2 Pasuritë	15
6.3 Trajtimi i borxheve	15
6.4 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor	16
7 Kontrolli menaxherial.....	16
7.1 Sistemet e kontrollit të brendshëm	16
7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm	17
8 Një konkluzion i përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Kuvendit të Kosovës	18
Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinionëve të Auditimit.....	19
Shtojca II: Rekomandimet e vitit të mëhershëm	21

Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit
LMFPP	Ligji 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji për Prokurimin Publik nr. 03/L-241 i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-042 në fuqi prej 05.10.2011
MF	Ministria e Financave
MF/K	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
PIP	Projekti i Investimeve Publike
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
Rr F	Rregullat financiare të nxjerra nga Ministria e Financave
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
SP	Sekretar i Përgjithshëm
UA	Udhëzim Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të Kuvendit të Republikës së Kosovës (më tutje Kuvendi) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat vjetore financiare.

Sipas opinionit tonë pasqyrat vjetore financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë. **(SNISA 400 Opinion i Pakualifikuar)**

Në krahasim me vitin e kaluar Kuvendi i ka kushtuar më shumë vëmendje rekomandimeve tona dhe si rezultat është arritur një progres i theksuar, sidomos tek menaxhimi i pasurive.

Konkluzioni ynë është që sistemi i kontrolleve të brendshme të Kuvendit është dizajnuar në mënyrën e duhur për eliminim e dobësive evidente dhe ka funksionuar si duhet. Megjithatë çështjet e mëposhtme do të duhej të adresohen për të përmirësuar edhe më tej performancën e aktiviteteve administrative.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, ne rekomandojmë Kryetarin e Kuvendit të siguroi që:

- Janë rishikuar dhe analizuar politikat dhe procedurat aktuale administrative, me theks të veçantë tek fusha e menaxhimit të proceseve të prokurimit; dhe
- Rekomandimet e auditimit të brendshëm janë adresuar si duhet dhe se Komiteti i Auditimit siguron mbështetje më të madhe.

Menaxhmenti i Administratës së Kuvendit i ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi pasqyrat vjetore financiare për vitin 2011 dhe është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me pasqyrat vjetore financiare të Kuvendit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e Kuvendit të përgatisë pasqyrat vjetore financiare sipas kërkesave të Rregullës Financiare nr. 07/2011 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për "Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme".

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë, të Kuvendit të Kosovës.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat vjetore financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Kemi kryer auditimin e përkohshëm të Kuvendit. Gjatë asaj faze të procesit të auditimit, kemi trajtuar faktin se si i keni adresuar rekomandimet e mëparshme si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Kemi këshilluar menaxhmentin. Kjo përfshin edhe këshillat dhënë për pasqyra vjetore financiare. Memorandumi i auditimit është dorëzuar në dhjetor 2011.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e Kuvendit, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar pasqyrat vjetore financiare të Kuvendit në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2011;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat vjetore financiare të Kuvendit janë përgatitur në pajtim me SNSKP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr.07/2011;
- Kemi përcaktuar nivelin e materialitetit të shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat vjetore financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer vlerësimin e kontrolleve të brendshme dhe testimin e tyre sipas nevojës;

-
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
 - Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
 - Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm të Kuvendit.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2011.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat vjetore financiare, standardet ndërkombëtare të auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 1.

2 Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat vjetore financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë. **(SNISA 400 Opinion i Pakualifikuar).**

3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar

Për Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2010, Kuvendit i është dhënë një opinion i pakualifikuar.

Raporti jonë i auditimit i PVF-ve për vitin 2010 kishte rezultuar me 6 (gjashtë) rekomandime kyçe. Kuvendi kishte përgatitur një Plan Veprimi duke theksuar që të gjitha rekomandimet do të adresohen.

Nga 6 (gjashtë) rekomandimet e dhëna, Kuvendi ka adresuar plotësisht 3 (tre) prej tyre, ndërsa 3 (tre) të tjerat i ka adresuar pjesërisht. Për një përshkrim më të hollësishëm të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën 2.

4 Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Vjetore Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1 Burimet e fondeve Buxhetore – aktuali ndaj buxhetit (në ‘€)

Burimet e fondeve buxhetore	Buxheti Fillestar	Buxheti Final ¹	2011 Të shpenzuara	2010 Të shpenzuara
Gjithsej:	16,767,921	16,740,873	15,932,921	8,608,297
Granti i Qeverisë - buxheti	16,767,921	16,738,328	15,931,298	8,601,715
Donacionet e jashtme	0	2,545	1,623	6,582

Tabela 1 paraqet mjetet e buxhetuara dhe të shpenzuara në total, sipas burimeve të fondeve. Buxheti final në krahasim me atë fillestar dallon si pasojë e ndryshimeve të ndodhura buxhetore gjatë vitit 2011 dhe përfshirjes së donacionit nga qeveria Zvicerane. Krahasuar me vitin 2010 vërehet një rritje e theksuar e buxhetit. Kjo ka ndodhur si pasojë e përfshirjes së mjeteve në shumë prej 7,900,000€ për financimin e RTK-së.

Poashtu janë paraqitur edhe mjetet e shpenzuara në total, nga granditë e qeverisë dhe nga donacioni.

Tabela 2 Shpenzimi i fondeve sipas kategorive ekonomike, aktuali ndaj buxhetit (në‘€)

Shpenzimi i fondeve sipas kategorive	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2011 Të shpenzuara	2010 Të shpenzuara
Gjithsej:	16,767,921	16,740,873	15,932,921	8,608,297
Paga dhe Mëditje	5,881,785	5,883,929	5,722,683	4,503,117
Mallra dhe shërbime	1,404,325	1,534,415	1,414,769	1,218,448
Shpenzimet komunale	221,000	164,807	163,639	202,010
Subvencionet dhe transferet	7,900,000	7,905,000	7,904,999	1,892,219
Investimet Kapitale	1,360,811	1,252,722	726,831	792,503

Në tabelën 2 janë paraqitur buxheti fillestar, buxheti final dhe shpenzimet e ndodhura në total dhe sipas kategorive ekonomike.

¹ Buxheti Final- buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Siç shihet edhe nga tabela buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar, në total është më i ulët për shumën prej 27,048€. Sipas kategorive ekonomike pas lëvizjeve buxhetore, dhe transfereve nga njëra kategori ekonomike në tjetrën, gjatë vitit 2011, dallimi në mes të buxhetit final dhe atij fillestar ishte:

- Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve kishte rritje prej 2,144€;
- Tek mallrat dhe shërbimet kishte rritje për 130,090€;
- Tek shpenzimet komunale kishte zvogëlim të buxhetit për shumën prej 56,193€;
- Tek subvencionet dhe transferet kishte rritje për shumën 5,000€; dhe
- Tek shpenzimet kapitale kishte zvogëlim të buxhetit për shumën prej 108,089€.

Në tabelë poashtu është paraqitur edhe realizimi i buxhetit. Kuvendi në total ka shpenzuar 95% të buxhetit final. Në të gjitha kategoritë tjera ekonomike përpos kategorisë së investimeve kapitale niveli i realizimit të buxhetit ishte i kënaqshëm.

Megjithatë dinamika e realizimit të buxhetit përgjatë vitit nuk ishte konform planifikimit sidomos tek kategoria e investimeve kapitale dhe mallrave e shërbimeve. Rreth 76% e shpenzimeve për investime kapitale janë kryer në tremujorin e fundit të vitit, ndërsa 55% janë kryer në dhjetor. Poashtu për mallra dhe shërbime 53% e shpenzimeve janë bërë në tre mujorin e fundit, ndërsa 32% në muajin dhjetor.

Konkluzioni

Kuvendi ka shpenzuar buxhetin për qëllimet e përcaktuara në fillim. Poashtu shpenzimet janë klasifikuar dhe raportuar konform kërkesave ligjore për raportim financiar. Megjithatë dinamikës së shpenzimeve duhet t'i kushtohet vëmendje e theksuar në mënyrë që të evitohen mospërputhjet kohore në mes të shpenzimeve dhe planit të rrjedhës së parasë.

Rekomandimi 1

Ne rekomandojmë Kryetarin e Kuvendit të siguroi që Sekretari i Përgjithshëm:

- Në mënyrë të vazhdueshme përcjell dhe analizon dinamikën e rrjedhjes së parasë me qëllim që të evitohet aq sa është e mundur ngarkimi i tepërt i muajve të fundit të vitit me pagesa.

5 Pasqyrat vjetore financiare – Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit

Ne kemi identifikuar pikat në vijim:

- Kuvendi ka përgatitur pasqyrat vjetore financiare në pajtueshmëri me Rregullën Financiare nr. 07/2011;
- Pasqyrat Vjetore Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- Pasqyrat Vjetore Financiare janë nënshkruar brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në MF;
- Pasqyrat Vjetore Financiare janë dorëzuar në gjuhën shqipe dhe serbe; dhe
- Informatat për pasuritë fikse dhe për borxhet, janë shpalosur si duhet dhe në mënyrë të sakte;

Konkluzioni

Mund të konkludojmë se informatat e shpalosura në PVF-të e Kuvendit prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtet në aspektin material dhe cilësor. Bazuar në pikat e cekura më lartë mund të themi se Kuvendi ka arritur t'i përmbush obligimet e veta sa i përket kërkesave ligjore për raportim financiar.

6 Menaxhimi financiar

6.1 Shpenzimet

6.1.1 Kompenzimet (pagat dhe mëditjet)

Buxheti final për kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve për vitin 2011 ishte 5,883,929€ ndërsa shpenzimet ishin 5,722,682€. Numri i pozitave të aprovuara për vitin 2011 ishte 320. Prej tyre 200 të punësuar, dhe 120 deputetët e kuvendit. Numri i të punësuarve në fund të vitit 2011 ishte: në administratën e kuvendit 161 të punësuar dhe 30 staf mbështetës politik.

Ne kemi testuar 63 mostra duke marrur në konsideratë kryesisht procesin e rekrutimit, shkëputjet e marrëdhënies së punës mirëmbajtjen e dosjeve, kemi krahasuar pagat nga lista e Payrollit me pagat në kontratat e të punësuarve si dhe kompensimet për pjesëmarrje në komisione të ndryshme.

Testimet tona nuk kanë gjetur ndonjë mangësi në menaxhimin e pagave dhe mëditjeve.

Konkluzion

Në bazë të testimeve tona konkludojmë që Kuvendi ka arritur të vendos procedurë adekuate lidhur me sistemin e pagave dhe mëditjeve.

6.1.2 Prokurimi

Kuvendi e kishte hartuar planin e prokurimit për vitin 2011 konform kërkesave ligjore. Bazuar në këtë plan, zyrtari i prokurimit kishte realizuar prokurime që kishin rezultuar me nënshkrimin e 94 kontratave me vlerë totale prej 1,273,636€.

Ne kemi testuar një numër prej 19 kontratave nga lista e kontratave të nënshkruara, me vlerë të përbashkët prej 961,506€. Po ashtu kemi rishikuar 20 pagesa nga kategoria e investimeve kapitale dhe 51 pagesa nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Përveç kësaj ne kemi shikuar edhe ndërlidhjen e projekteve kapitale të realizuara me Programin e Investimeve Publike (PIP). Testimet tona kanë treguar se projektet kapitale të realizuara nga Kuvendi ishin të regjistruara edhe në PIP, dhe raportet e programit përputheshin me ato të SIMFK

Mangësitë të cilat i kemi identifikuar gjatë testimeve tona, po i paraqesim më poshtë:

Kushtet e veçanta të kontratës të pa specifikuar

Tek kontrata për renovimin e aneksit në ndërtesën e Kuvendit me vlerë prej 428,403€, kriteri për shpalljen e fituesit ishte oferta ekonomikisht më e favorshme, ndërsa nënkriter

ishite plani dinamik i kryerjes së punimeve. Në kontratë nuk ishte specifikuar data e fillimit dhe e përfundimit të punimeve si dhe as kushtet tjera të veçanta të kontratës.

Poashtu as tek kontratat tjera që kanë të bëjnë me investime kapitale, kushtet e veçanta nuk ishin specifikuar.

Mospërfshirja e kontratës në regjistrin e kontratave të nënshkruara

Kontrata për rifreskimin dhe pavarësimin e sistemit të Teknologjia Informative e Kuvendit (TIK), me vlerë prej 120,000€, e nënshkruar në muajin dhjetor nuk ishte e përfshirë në regjistrin e kontratave të nënshkruara që është dorëzuar në KRPP.

Anashkalim i procedurave administrative gjatë procesit të prokurimit

Tek procedura e prokurimit për demolimin e gypave dhe furnizimin me gypa të rinj për mbledhjen e ujërave atmosferik nga kulmi i objektit të anex-it, me vlerë prej 9,896€, nuk ishte bërë njoftimi për dhënie të kontratës. Poashtu kontrata është nënshkruar pa kaluar tre ditë pune siç parashihet me dispozita ligjore.

Mos plotësim i kritereve të përcaktuara në dosje të tenderit

Tek procedura e prokurimit për furnizim me TV për nevojat e Kuvendit në dosjen e tenderit ishte kërkuar që fituesi të sjell dëshmi për shlyerje të borgjit ndaj KEK-ut. Në raportin e vlerësimit të ofertave ishte cekur që tre ofertuesit e kanë plotësuar këtë kriter. Përderisa, gjatë testimit ne kemi vërejtur se asnjëri nga ofertuesit nuk kishte prezantuar ndonjë dëshmi të tillë.

Po ashtu, tek procesi i prokurimit për furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative dhe telefona, në dosjen e tenderit ishte kërkuar që fituesi i kontratës të prezantoj dëshmi për shlyerje të borxhit ndaj KEK-ut. Gjatë testimit ne nuk kemi gjetur dëshmi se i njëjti e ka shlyer borgjin ndaj KEK-ut.

Më tutje, në asnjërin nga kontratat e lartcekura nuk është specifikuar afati i realizimit të furnizimeve.

Konkluzion

Mund të konkludojmë se me gjithë progresin e arritur menaxhimi i prokurimit, akoma nuk është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të Ligjit mbi Prokurimin Publik dhe sistemi i kontrollit në këtë fushë edhe më tej ka nevojë për përmirësim. Përfshirja në kontratë e afatit për kryerjen e punimeve dhe të specifikacioneve tjera të veçanta është e nevojshme për të lehtësuar mbikëqyrjen e ekzekutimit të kontratave.

Rekomandimi 2

Ne rekomandojmë Kryetarin e Kuvendit të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm ka marrë masat e duhura që:

- Të bëhen njoftimet për dhënie të kontratave konform kërkesave ligjore;
- Kontratat të nënshkruhen vetëm pasi të ketë kaluar koha e paraparë pas njoftimit për dhënie të kontratës;
- Janë specifikuar kushtet e veçanta në të gjitha kontratat e nënshkruara, në mënyrë që mbikëqyrja e realizimit të tyre të jetë më e mirë; dhe
- Janë nënshkruar kontratat, vetëm me operatorët ekonomik të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në dosjet e tenderit.

6.1.3 Blerjet tjera

Në kategorinë e blerjeve tjera përfshihen të gjitha blerjet e mallrave dhe shërbimeve për të cilat nuk ka nevojë të zhvillohen procedura të prokurimit.

Nga kjo kategori e shpenzimeve ne kemi testuar shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit. Gjatë vitit 2011 Kuvendi nga kjo kategori kishte shpenzuar shumën prej 204,944€, pa përfshirë këtu shpenzimet për bileta të cilat janë kryer përmes prokurimit. Prej tyre për akomodim 40,366€, mëditje 143,012€ dhe shpenzime tjera të udhëtimit 21,566€.

Ne kemi testuar 12 mostra, dhe testimet tona nuk kanë treguar ndonjë mangësi gjatë përllogaritjes së shpenzimeve, dhe mënyrës së shpenzimit të tyre.

Konkluzion

Kuvendi ka realizuar blerjet tjera në pajtim të plotë me kornizën e aplikueshme ligjore. Autorizimi, klasifikimi, regjistrimi, llogaritja dhe raportimi i shpenzimeve nga blerjet e tjera është bërë konform autorizimeve, tarifave të aprovuara, planit kontabël dhe kërkesave ligjore për raportim.

6.1.4 Subvencionet dhe transferet

Me Ligjin e Buxhetit në kuadër të buxhetit të Kuvendit, ishte futur si program Radio Televizioni i Kosovës (RTK). Mjetet në shumë prej 7,905,000€ të ndara për këtë program i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve. Gjatë vitit nga kategoria e subvencioneve, Kuvendi kishte shpenzuar shumën prej 7,904,999€. Prej tyre 7,900,000€ i janë paguar RTK-së në bazë të projeksioneve buxhetore të aprovuara nga Kuvendi, ndërsa pjesa tjetër ishin donacione për përfitues individual.

Testimet tona nuk kanë evidentuar ndonjë mangësi të procesit të menaxhimit të kësaj kategorie të shpenzimeve.

Konkluzion

Konkludimi ynë është se Kuvendi i ka shfrytëzuar subvencionet dhe transferet në pajtim me projeksionet buxhetore të aprovuara paraprakisht.

6.2 Pasuritë

6.2.1 Trajtimi i pasurive kapitale dhe jo-kapitale

Ne kemi testuar edhe menaxhimin e pasurisë, duke përfshirë regjistrat e pasurisë inventarizimin si dhe vlerësimin e pasurisë. Kuvendi ka rekrutuar zyrtarin e pasurisë, dhe ka krijuar një regjistër të brendshëm të pasurisë i cili është në përputhje me kërkesat ligjore. Zyrtari i pasurisë ka arritur të regjistroi në këtë regjistër të gjitha pasuritë. Poashtu edhe regjistri kontabël (SIMFK) është azhurnuar.

Në PVF pasuritë janë paraqitur sipas vlerës së tyre neto. Pasuritë kapitale apo me vlerë mbi 1000€ kishin vlerë prej 7,149,611€, ndërsa pasuritë jokapitale kishin vlerë neto prej 484,356€.

Secili zyrtar i Kuvendit ngarkohet me inventarin dhe pajisjet në momentin e marrjes së tyre në shfrytëzim, megjithatë gjatë verifikimit fizik ne kemi vërejtur se regjistrat nuk janë azhurnuar përgjatë viteve.

Konkluzion

Në bazë të asaj që u cek më lartë konkludojmë se Kuvendi ka bërë progres të theksuar në menaxhimin e pasurisë, duke arritur ta implementoi rekomandimin tonë nga viti i kaluar në lidhje me këtë fushë të menaxhimit.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë Kryetarin e Kuvendit të sigurojë që Sekretari i Përgjithshëm ka marrë masat që:

- Regjistrat e inventarit dhe pajisjeve që ka në shfrytëzim secili zyrtar i Kuvendit janë azhurnuar për çdo vit, në mënyrë që secili punonjës të dijë se me çfarë është i ngarkuar.

6.3 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2011 ishte në vlerë prej 52,364€. Këto obligime kanë të bëjnë kryesisht me shërbime dhe furnizime që janë bërë në dhjetor. Shumica e faturave për këto shërbime janë pranuar pas mbylljes së afatit për pagesa dhe të njëjtat barten për pagesë në vitin fiskal 2012.

Konkluzioni

Konkludojmë se Kuvendi brenda mundësive është përpjekur që ti paguaj të gjitha faturat e pranuar para skadimit të afatit të pagesave, në mënyrë që sa më pak obligime të barten në vitin e ardhshëm. Obligimet e mbetura janë trajtuar dhe raportuar konform kërkesave ligjore për raportim financiar.

6.4 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor

Kuvendi kishte përmbushur edhe kërkesat aktuale për raportim të jashtëm duke përfshi:

- Kuvendi ka përgatitur me kohë Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, dhe pasqyrat financiare nëntëmujore janë përgatitur me kohë dhe janë dërguar me kohë në MF;
- Draft Plani dhe plani final i prokurimit ishte përgatitur në kohën e paraparë; dhe
- Raporti mbi borxhet është shpalosur në PVF dhe është dorëzuar në MF;

Konkluzioni

Nga pikat e paraqitura më lartë konkludojmë që Kuvendi ka vepruar konform kërkesave për raportimin e jashtëm. Poashtu Kuvendi kishte përgatitur edhe planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve nga auditimi ynë i vitit të kaluar.

7 Kontrolli menaxherial

7.1 Sistemet e kontrollit të brendshëm

Në bazë të shpalosjeve më lartë konkludojmë se Kuvendi, në shumicën e fushave të menaxhimit financiar ka sisteme të mira të kontrollit të brendshëm. Megjithatë mangësitë e identifikuara brenda këtij raporti tregojnë që Kuvendi duhet t'i rishikoj politikat e brendshme dhe programet ekzistuese.

Kuvendi ka strukturën e vet organizative në bazë të së cilës edhe janë të përcaktuara linjat e raportimit, dhe përshkrimi i detyrave e përgjegjësive të secilit punonjës. Vlerësimi i stafit behet rregullisht në fund të vitit për të përcaktuar arritjen e objektivave individuale. Poashtu Kuvendi ka nxjerrur akte nënligjore, udhëzime të brendshme dhe vendime që rregullojnë disa fusha të menaxhimit financiar, dhe ka shtuar kontrollet tek menaxhimi i pasurive dhe pagesave.

Përmirësimi i menaxhimit të pasurive, ka ndihmuar Kuvendin në sigurimin e informatave të sakta në lidhje me pasuritë kapitale dhe jokapitale. Poashtu rritja e

kontrolleve në procesimin e pagesave ka evituar pagesat që nuk janë në pajtim me kushtet e kontraktuara.

Pavarësisht progresit të arritur, Kuvendi duhet edhe me tutje t'i rishikoj proceset lidhur me planifikimin dhe realizimin e projekteve kapitale, menaxhimin e prokurimit si dhe forcimin e mëtejme të NjAB-së, dhe funksionalizimin e plotë të Komitetit të Auditimit.

Konkluzioni

Kuvendi ka bërë punë të mirë në drejtim të dizajnit dhe funksionalizimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm që do të mundësojnë realizim të detyrave konform objektivave administrative dhe operative.

7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm

Kuvendi ka të punësuar një Auditor të Brendshëm (AB) i cili është i sistemuar në kuadër të zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm. AB kishte hartuar planin vjetor të auditimit për vitin 2011. Në bazë të planit vjetor, AB kishte planifikuar 4 auditime, të cilat mbulonin periudhat kohore 2010 dhe 2011. AB kishte kryer 4 auditimet e planifikuara, dhe një auditim tjetër me kërkesë të veçantë të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

Auditimet e kryera kanë mbuluar fushat si: menaxhimi i veturave, prokurimi, shërbimet e bufesë, dhe implementimi i rekomandimeve nga auditimet e mëhershme. Poashtu një auditim është kryer edhe në Komisionin e Pavarur Mbikëqyrës në lidhje me buxhetin, pagesat dhe menaxhimin e pasurisë.

Në raportet e kryera Auditori i Brendshëm kishte evidentuar disa mangësi për të cilat kishte dhënë rekomandime të dobishme për evitimit e tyre.

Nga auditimi që ishte kryer në fund të vitit dhe që kishte për objektiv implementimin e rekomandimeve të AB ka rezultuar që nga gjithsej 33 rekomandime sa kishte dhënë AB, 9 (nëntë) prej tyre ishin implementuar pjesërisht ndërsa 9 të tjera nuk ishin implementuar fare.

Kuvendi po ashtu e ka të themeluar Komitetin e Auditimit (KA) i cili përbëhet nga tre anëtar. Ky komitet ka mbajtur vetëm dy takime gjatë vitit 2011, dhe atë me kërkesë të sekretarit të përgjithshëm të Kuvendit.

Konkluzion

Auditimi i brendshëm gjatë vitit 2011 ka funksionuar në nivel të kënaqshëm. Mirëpo nuk e ka pasur mbështetjen e duhur nga ana e komitetit të auditimit të brendshëm. Një komitet funksional i auditimit do ta ndihmonte menaxhmentin në adresimin e përgjegjësive të personelit për zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe, do të ndihmonte lidhur me adresimin e rekomandimeve të dalura nga raportet e NJAB-së.

Rekomandimi 4

Ne rekomandojmë Kryetarin e Kuvendit të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm ka marrë masa që të siguroi se:

- Komiteti ka mbajtur takime të rregullta, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që NjAB së t'i ofrohet përkrahje më e madhe; dhe
- Të gjitha rekomandimet që kanë dalë nga auditimet e brendshme të adresohen.

8 Një konkluzion i përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Kuvendit të Kosovës

Konkludimi ynë i përgjithshëm është se Kuvendi ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të krijuar procedura administrative funksionale për të siguruar një menaxhim efikas të burimeve. Këto procedura kanë gjetur zbatim pothuajse në çdo segment administrativ dhe financiar në përjashtim të disa mangësive të cilat nuk kanë ndikim material.

Sistemi i informacionit në Kuvend ka siguruar raporte të brendshme dhe të jashtme me kohë dhe informata të plota dhe të sakta. Kjo për faktin që PVF 2011 dhe raportet e tjera financiare janë përgatitur në pajtim me kornizën e kontabilitetit dhe kërkesat aktuale për raportim të jashtëm. Adresimi i rekomandimit për menaxhimin e pasurive ka rezultuar me përmirësim të gjendjes në këtë fushë.

Megjithatë, aktivitetet e kontrollit gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit nuk kanë qenë plotësisht funksionale. Po ashtu, komiteti i auditimit nuk kishte funksionuar në nivelin e dëshiruar. KA do t'i siguronte mbikëqyrje të pavarur planeve dhe rezultateve të AB-së dhe do t'i ndihmonte menaxhmentit në kontrollin dhe menaxhimin më të mirë të financave publike.

Rekomandimi 5

Me qëllim të përmirësimit të mëtutjeshëm në zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ne rekomandojmë Kryetarin e Kuvendit që në veçanti të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Ka rishikuar dhe analizuar politikat dhe procedurat aktuale administrative, me theks të veçantë ato në fushën e menaxhimit të prokurimit me qëllim të arritjes së plotë të objektivave të përcaktuara me kërkesat e reja të Menaxhimit të Financave Publike.

Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga SNISA 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);

b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;

c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;

d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;

b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo

c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit të mëhershëm

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të implementuara	Pjesërisht të adresuar	Të pa adresuara
III. Gjendja e rekomandimeve nga viti i kaluar	Ti kushtohet më tepër vëmendje adresimit të rekomandimeve tona me qëllim të përmirësimit të menaxhimit financiar.	Po		
IV. Buxheti i shpenzuar në krahasim me Buxhetin e aprovuar	Të analizohen shkaqet e ngecjes së realizimit të projekteve më kohë dhe të marrë masa për adresimin e tyre.		Me gjithë përpjekjet e bëra, gjendja është e njëjtë si vitin e kaluar	
V. 3 Shpenzimet 3.1 Blerjet përmes prokurimit	Të analizohen proceset e prokurimit dhe të kërkohet përgjegjësi, në veçanti vëmendje ti kushtohet kërkesave të LPP-së. Të krijohet sistem i mbikëqyrur dhe më transparent i prokurimit, të hartohen specifika teknike të qarta dhe nëpërmjet kontrollit të pagesave të parandalohen pagesat që nuk janë në përputhje me kontratat.		Kontrollet e pagesave nuk kanë lejuar pagesa në shpërputhje me kontratat, poashtu specifikat teknike ishin më të qarta. Megjithatë disa kërkesa ligjore akoma mbeten pa u respektuar plotësisht.	

V. 3 3.5 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Të krijohet një regjistër i pasurive më shënime të plota konform kërkesave ligjore.	Po		
VI. 1 Sistemet e kontrolleve të Brendshme	Të përmirësohet sistemi i kontrollit të brendshëm duke eliminuar të gjitha dobësitë që e përcjellin atë.	Po		
VI. 2 Auditimi i brendshëm	T'i ofrohet mbështetje e vazhdueshme NjAB-së dhe njëherit të sigurohet që në planin e auditimit të përfshihen më shumë aktivitetet e periudhës aktuale.		Aktivitetet e auditimit janë përqendruar më tepër në periudhën aktuale, ndërsa sa i përket mbështetjes duhet akoma më shume punë. Komiteti i auditimit kishte mbajtur vetëm dy takime gjatë vitit ndërsa disa rekomandime të Auditimit të brendshëm kanë mbetur pa adresuar.	